

VENDIM
Nr. 498 , datë 29.7.2022

PËR KALIM FONDI MINISTRISË SË INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
PËR MBËSHTETJEN E SEKTORIT ENERGJETIK

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 11, të ligjit nr.115/2021, “Për buxhetin e vitit 2022”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë dhe të ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, në programin 04320, “Mbështetje për energjinë”, në llogarinë ekonomike nr.232, i shtohet fondi 8 000 000 000 (tetë miliardë) lekë, në formën e transferimit në kapital (transhi i parë nga fondi i miratuar për këtë qëllim në buxhetin e shtetit), për shoqërinë “Korporata Elektroenergjetike Shqiptare (KESH)”, sh.a., me qëllim mbulimin me likuiditet të veprimtarisë operationale të shoqërisë.

2. Fondi i përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, përballohet nga zëri “Mbështetje buxhetore për sektorin energjetik”, miratuar për buxhetin e vitit 2022.

3. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe “Korporata Elektroenergjetike Shqiptare (KESH)”, sh.a., për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama